



Ref. nr. 1311/1 Prishtinë 13.04. 2021

**PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER
DEPARTAMENTI HIDROTEKNIKËS**

Studenti Samir Bungu, ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Menaxhimi i Resurseve Ujore për Akumulimin e Dragaçinës – Komuna e Suharekës", në programin e studimeve Master konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Në këtë punim, fillimisht u vunë në pah disa karakteristika inxhinieriko-gjeologjike dhe fiziko-mekanike për pellgun e lumit Dragaçina. Poashtu në aspektin gjeomekanik është arritur edhe definimi i zonës në të cilën duhet të shtrihet materiali për filtër. Qëllimi kryesor i këtij punimi qëndron në analizën hidrologjike të lumit Dragaçina dhe vlerësimin e sasisë së disponueshme të ujit përkatësisht përcaktimin e një vëllimi të shfrytëzueshëm në këtë lumë. Për të arritur këto qëllime, fillimisht u tentua plotësimi i të dhënave të reshjeve për stacionin hidrometrik në Suharekë. Megjithatë përpjekjet për një linearitet ndërmjet stacioneve hidrometrike Suharekë, Prizren, Ferizaj dhe Prishtinë dështuan, duke rezultuar me një korrelacion të ulët ($r=0.39$). Me anë të regresionit jolinear është arritur një varshmëri e rëndësishme ndërmjet tyre ($r \cong 0.62$). Në bazë të reshjeve dhe karakteristikave të pellgut janë ndërtuar lakoret IDF për Suharekë. Këto lakore ndihmuan më pas në përcaktimin e ujërave të plota me perioda të caktuara kthyesë, kryesisht nëpërmjet metodave indirekte (metoda SCS). Për serinë e reshjeve dhe prurjeve në dispozicion bëhet edhe një analizë e trendit. Duke njohur varshmërinë ndërmjet reshjeve totale dhe atyre efektive, u mundësua transformimi i reshjeve në rrjedhje për një periudhë të shëndosh 30 vjeqare. Me qëllim të vlerësimit të homogjenitetit të serisë kohore të prurjeve, u bënë simulime në bazë të modelit të Markov-it të rendit të parë. Në bazë të kriterëve statistikore u përcaktua se për kohën e ndryshimit, ndryshimi ndërmjet nënserive nuk ishte statistikisht domethënës nën nivelin 5% të gjasës.

Sipas analizës statistikore të ujërave të vogla u përcaktuan edhe funksionet teorike të shpërndarjes së probabilitetit të prurjeve minimale vjetore. Në harmoni me këto funksione, minimumi i garantuar ekologjik në periudhën ekstra-vegjetative u përvetësua 37 l/s, ndërsa në atë vegjetative 55 l/s. Përcaktimi i vëllimit të shfrytëzueshëm në akumulim u bë sipas lakores kumulative të prurjeve. Nga kjo rrjedh se, për një vëllim të shfrytëzueshëm 4.5 hm³, me kusht që 1 hm³ të jetë vëllim fillestar, akumulimi mund të shkarkon në 8 muaj të vitit nga 200 l/s, ndërsa në 4 muaj të tjerë nga 150 l/s, pa llogaritur këtu prurjen ekologjike (Q_{em}).

Fjalët kyçe: Analizë e trendit, pellgu i Dragaçinës, funksione të shpërndarjes së probabilitetit, vëllim i shfrytëzueshëm, menaxhim i niërave

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.